



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI I KOMBINUAR

NGA SHKENCAT NATYRORE DHE SHOQËRORE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <http://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numri e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 628202113141

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrethë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

TESTI I KOMBINUAR

1. Automobili udhëtoi 10 minuta nëpër autoudhë, ashtu që gjatë çdo minuti kaloi nga 1,5 kilometër rrugë. Çfarë është lëvizja e automobilit?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- e njëtrajtshme e nxituar e ngadalësuar e ndryshueshme

2. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.


Menzura shërben për matjen e:

- masës; peshës; vëllimit; sasisë së substancës.

3. Dy bateria me tension nga 1,5 V janë lidhur si në figurë. Sa është tensioni mes pikave 1 dhe 2?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 0 V
 1,5 V
 3 V
 4,5 V



4. Trupi nga gjendja e prehjes fillon të lëviz me nxitim $4 \frac{\text{m}}{\text{s}^2}$. Sa është rruga e kaluar pas 10 sekondave të lëvizjes? (Rruga e kaluar të lëvizja e nxituar pa shpejtësi fillestare llogaritet sipas formulës $s = \frac{at^2}{2}$.)

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 20 m 100 m 200 m 400 m

5. Me cilin prej këtyre simboleve kimike shenohet oksigjeni?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- K O H N

6. Nëse kemi tretje të ngopur të kripës së kuzhinës në ujë, e ne dëshirojmë që të jetë e pangopur, çka duhet të bëjmë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ta avullojmë ujin të shtojmë akoma kripë të shtojmë akoma ujë ta përziejmë tretjen

7. Sa është masa molekulare relative e ujit?

$$Ar(O) = 16, Ar(H) = 1$$

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 17 g 17 18 g 18





8. Si quhet njësia themelore ndërtuese e të gjitha qenieve të gjalla?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- organizëm organel organ qelizë

9. Cila sëmundje mund të bartet përmes organeve gjinore?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- rahitis sida gastritis astma

10. Cilat nga këto shtazë **nuk** i përkasin grupit të kurrizorëve?
Ngjyros rrethin nën figurën e cila paraqet përgjigjen e saktë.

			
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

11. Lakuriqi, mushkonja dhe pëllumbi u janë përshtatur jetës në mjedisin ajror. Cila veti e përbashkët ia bën të mundur këtë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë:

- lindin të vegjëlit
 marrin frymë përmes mushkërive
 lëvizin me fluturim
 kanë penda notuese

12. Ngjyros rrethin në fushën e duhur, duke lidhur llojin e qelizave të njeriut në përputhje me funksionin e tyre:

	formohen me mitozë	formohen me mejozë	përmbajnë 23 kromozome	përmbajnë 46 kromozome
qelizat e mëlqisë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
spermatozoidët	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

13. Cilat hapësira (zona) në Tokë janë dendur të banuara? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- viset polare
 malet e larta
 luginat lumore të plleshme
 viset shkretimore

14. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë. Serbia për nga pozita gjeografike është:

- shtet bregdetar
 shtet ballkanik
 shtet alpin
 shtet pirinej

15. Ngjyros rrethin në fushën përkatëse, përkatësisht lidh shtetin me gadishullin (siujëdhësën) ai ku gjendet.

	Greqia	Italia	Spanja
Pirinej	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Apenin	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ballkanik	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

16. Cilët lumenj mund të shkaktojnë përmbytje (vërshime) në Maçvë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Tisa dhe Danubi
 Sava dhe Drina
 Timoku i Bardhë dhe i Zi
 Morava Jugore dhe Perëndimore

17. Trego cilit shekull dhe dekadë i takon viti 1690, në të cilin është zhvilluar Dyndja e Madhe Serbe prej Perandorisë Osmane në Perandorinë Austriake?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së sakt.

- Shekullit XVII , dekadës së nëntë Shekullit XVI , dekadës së nëntë
 Shekullit XVII , dekadës së tetë Shekullit XVI , dekadës së tetë

18. Në cilat kontinente shtrihej territori i Perandorisë Romake?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Amerika, Azia dhe Evropa
 Australia, Azia dhe Evropa
 Afrika, Azia dhe Evropa
 Amerika, Australia dhe Evropa

19. Ngjyros rrethin nga kolona përkatëse, ashtu që të lidhësh personalitetin dhe periudhën historike në të cilën ka jetuar.

	Periudha e vjetër	Periudha e mesjetës	Periudha e re
Aleksandri i Madh	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fridrih Barbarosa	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Napoleon Bonaparta	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

20. Lexo me kujdes fragmentin prej burimit historik dhe përgjigju në pyetjen.

Cilës datë i takon burimi historik?

„Pasi Qeveria e Mbretërisë Serbe nuk ka dhënë përgjigjen e knaqëshme në notë, të cilën e kishin dorëzuar deputeti austrohungarez në Beograd, Qeveria e Perandorisë e sheh si të nevojshme që vet të kënaq interesat dhe të drejtat në mënyrë që t'i shmanget përdorimit të forcës. Austrohungaria llogaritë, që prej këtij momenti ndodhet në gjendje lufte me Serbinë.”

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 28 qershor 1908 28 korrik 1912 28 qershor 1914 28 korrik 1914



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI I KOMBINUAR

NGA SHKENCAT NATYRORE DHE SHOQËRORE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR